



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE URBANE

Elbasan, më ____/____/2024

Procesverbal -Tipi i kontrates - Mall

(Për argumentimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit)

OBJEKTI I PROCEDURËS - “Blerje materiale për sinjalistikën horizontale (Bojra, dilyent etj...)”.

LLOJI PROCEDURËS- “Procedurë e hapur e thjeshtuar” - Marrëveshje kuadër me një operator ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara- Mall

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Kodi CPV: 39541140 - 9 - Spango; 43312500 - 8 – Rule mekanike; 44811000 – 8 – Bojra për rrugë

VLERA E FONDIT LIMIT - 2,500,000 (dymilion e pesëqindmije) lekë pa t.v.sh.

Ne bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontrator Agjencia e Shërbimeve Publike ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 7

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkm, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 03 Datë 09.06.2021 te miratuara nga APP.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. Formulari i Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

Kriteri (1-a) është vendosur në përputhje me Dokumentat e Tenderit të miratuara nga APP bazuar në Vendimit Nr. 03 Datë 09.06.2021 si dhe bazuar në Ligjin Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”

Kriteri (1-b) është vendosur në bazë të nenit 83 të LPP dhe nenit 30 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Kriteri (1-c) bazohet në nenet 76, 77 dhe 82 të LPP si dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.1. Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë:

Sipas Shtojcës 8.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2.1 Kopje te deklaratave te xhiros vjetore te leshuara nga administrata tatimore pergjate tre viteve te fundit, ku vlera e xhiros per te pakten nje nga vitet e periudhes se kerkuar duhet te jete jo me e vogel se **40%** e vleres se fondit limit.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet te ketë paguar **taksat dhe tarifate vendore për vitin 2024 (këstet e maturuara)** për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifate vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kriteri 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43 dhe nenit 55 pika 4 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik",si dhe bazuar ne Nenin 77 pika 3,e LPP nr.162,date 23.12.2020 "Per Prokurimin Publik".

Argumentimi: Kriteri 2.2.2 eshte vendosur bazuar ne nenin 76, pika 2 te LPP sidhe ne ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" I ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se **20%** e vleres se perlllogaritur te kontrates, qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjate tre viteve të fundit, nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) **Ne rastin e pervojës se mëparshme te realizuar me sektorin publik,** operatori ekonomik duhet te paraqese vertetime te leshuara nga nje ent publik ose fatura tatimore te shitjes, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të e mallrave të furnizuara,

ose

- b) **Në rast se pervoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat,**si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje,te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi,dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të e mallrave të furnizuara.
-

Argumentimi: Kriteri 2.3.1 është vendosur referuar nenit 55 pika 4 gërma "b" te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"si dhe bazuar ne nenin 77 pika 4 te LPP nr.162,date 23.12.2020 "Per Prokurimin Publik". Vendosja e ketij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues ka përvojën e duhur per te permbushur me sukses kontraten.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet te paraqese çertifikaten e meposhtme :

- SSH/EN-ISO 9001-2015" Sistemi i Menaxhimit te Cilesise" ose ekuivalente, e vlefshme dhe të perputhet me mallin objekt prokurimi.

Çertifikata e mesiperme duhet te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise.

Argumentimi: Kriteri 2.3.2 eshte vendosur ne perputhje me Nenin 40 pika 6 germa c te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", bazuar ne nenin 44 pika 1 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 si dhe bazuar ne nenin 79 te LPP.

Ky kriter eshte vendosur qe AK te kete sigurine qe operatori ekonomik qe do te ofertoje te jete i pajisur me certifikaten e menaxhimit te cilesise gje e cila krijon bindjen dhe sigurine te AK qe ky OE do te ofertoje produkte te certifikuara te nje cilesie te mire e ne perputhje me standartet nderkombetare te cilesise.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet te **disponoje nje automjet të përshtatëm për transport me kapacitet mbajtes minimalisht 500kg**, për transportin e mallit objekt prokurimi, per te cilin duhet te paraqese dokumentat e meposhtem:

- *Aktin e pronësisë së mjetit perkatës;*
- *Kontratën noteriale te marrjes me qira të mjetit,* shoqëruar me dokumentacionin përkatës tëpronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira.

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë (qoftë në pronësi apo dhe me qira) duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi),çertifikata e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, taksat vjetore si dhe lejen e transportit për vete ose të trete per ato mjete qe pajisen me leje transporti sipas legjislacionit ne fuqi.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e automjetit, dorëzohet nga ofertuesi

i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.3.4 Në rast se operatori ekonomik ofertues nuk është prodhues, ai duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori për mallin objekt prokurimi katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve ose skeda teknike të prodhuesit/ve, ku të dallohen qartë specifikimet teknike të saj. Në rastin e autorizimit me distributorin të dokumentohet lidhja e tij me prodhuesin. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme nga Autoriteti Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur pasi është në përputhje me objektin e prokurimit dhe bazuar në nenin 40, pika 6 germa b dhe pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

2.3.5 Operatorët Ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, duhet të paraqesin mostrat për elementet e mëposhtme sipas preventivit dhe specifikimeve të kërkuara në datën dhe orën e hapjes së tenderit në ambjentet e Agjencisë së Shërbimeve Publike Urbane, Bashkia Elbasan, adresa: Lagje Visarion Xhuvani, Rruga e Re, Elbasan), konkretisht:

Nr	Emertimi i mallit	Njesia
1	Boje e Bardhe Vijezi paste	kg
2	Boje e Verdhe Vijezi akrelike	kg
3	Boje e kuqe Vijezi paste	kg

Argumentimi: Kriteri **2.3.5** bazohet në Nenin 40 pika 6, germa a) të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe është vendosur duke pasur parasysh numrin e konsiderueshëm dhe natyrën specifike të këtij produkti, për të dëshmuar autoritetit kontraktor se malli i ofruar plotëson kërkesat e pecaktuara në dokumentat e tenderit.

2.3.6 Per Bojen , operatori ekonomik duhet te paraqese:

- Skedat teknike si dhe raportet e testimi nga laboratorë të akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara për mallrat objekt prokurimi.
- Deklaratë konformiteti CE sipas aneksit III te rregullores EU No.305/2011 për mallrat objekt prokurimi
- Skedat e sigurise për mallin objekt prokurimi

Argumentimi: Kriteri 2.3.6 bazohet ne Nenin 40 pika 6 , germa b dhe c dhe pika 8 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” janë vendosur duke pasur parasysh natyren specifike te ketij produkti, per ti deshmuar autoritetit kontraktor se malli i ofruar ploteson kerkesat e percaktuara ne dokumentat e tenderit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Specifikimet teknike hartohen nga specialisti i fushës për objektin që prokurimet. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.
